

Omologjet Emiliani i Kizikës. Mironi i Kretës. Dëshmor i ri Triandafili



E premte, 8 gusht 2024 – Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E HYJLINDËSES MARI (1-15 gusht)

Omologjet Emiliani i Kizikës. Mironi i Kretës. Dëshmor i ri Triandafili.

– OMOLOGJET (RRËFYES/POHUES I BESIMIT) EMILIANI I KIZIKËS –

Fillimisht ishte murg në manastirin e themeluar nga shën Tarasi (25 shkurt) dhe shkëlqeu nga virtytet. Pas pak kohësh, u ngrit në gradën episkopale dhe pasoi në vendin e mitropolitit të Kizikës, Nikolla (pas 788).

Gjatë konferencës për nderimin e ikonave, që u thirr në pallatin e perandorit Leon V, më 815, shën Emiliani kundërshtoi qeveritarin heretik dhe i tha se çështja e dogmave ishte e rangut kishtar, dhe se duhet të trajtohej në kishë dhe jo para autoriteteve civile. Nga ky rrëfim i guximshëm, e internuan. Dhe pas 5 vjet sprovash ai vdiq; mendohet se është vrarë nga agjentët e perandorit, kështu ai u bashkua në qiell me korin e shenjtorëve martirë. Emiliani (latinisht do të thotë: ai që konkuron).

Sipas Menologut të Vasilit II, ai vdiq në paqe kur ishte i internuar.

* * * * *

– EPISKOP MIRONI I KRETËS –

Shën Mironi lindi në Avrakia të Kretës, në një familje të krishterë. Ende i ri, u

martua dhe punoi si bujk. I shtyrë nga dashuria për të afërmin, u shpërndante shumë lëmosha të varfërve, dhe sa më shumë jepte, aq më të shumta i kishte të korrat.

Një ditë, gjeti në magazinën e grurit disa burra që po e vidhnin. Babëzia e tyre ishte aq e madhe, saqë i mbushën deri në majë thasët dhe nuk mundnin dot t'i lëviznin vendit. Kur Mironi i kapi duke vjedhur, nuk i dëboi, por i ndihmoi t'i ngarkonin thasët. I porositi mos t'i tregonin njeriu se çfarë kishte ngjarë, për të mos e humbur shpërblimin.

Virtytet e denjësuat për priftërinë dhe në fund të Persekutimit të Madh të Dioklecianit, u hirotonis episkop i Gortinës dhe kryepiskop i Kretës. Përveç urtësisë së tij të madhe, e ndihmoi grigjën e tij shpirtërore edhe me anë të mrekullive të shumta. Shën Mironi drejtoi për shumë vjet grigjën që iu besua, duke derdhur pa kursim hirin e Perëndisë që i qe dhënë. Fjeti në paqe, rreth moshës 100-vjeçare (viti 350).

* * * * *

– DËSHMORI I RI TRIANDAFILI (TRËNDAFILI) –

Dëshmori i ri Triandafil (Trëndafil) lindi në vitin 1633, në Zagora të Magnezisë. Punoi që i vogël si marinar, në një nga anijet më të njohura të Zagorës. Në vitin 1680, anija ku punonte u ankorua në portin e Konstandinopojës, dhe Triandafil pati mundësinë të shohë e të lutet në kishat e qytetit. Atje hyri në konflikt me disa turq, të cilët shpifën se gjoja donte që të bëhej muhamedan.

Triandafil i kundërshtoi fort shpifjet e tyre dhe qëndroi i palëkundur në bindjet dhe besimin e tij të krishterë. Kështu, e dënuan me vdekje në hipodromin e Konstandinopojës, duke i dhuruar kurorën e pavyshkur të martirizimit ndërsa ishte vetëm 18 vjeç. Në Zagora nderohet shumë kujtimi i tij dhe një pjesë e lipsanit të shenjtorit ndodhet në ishullin Andros, në manastirin e Shën Nikollës.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)